



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 235, Datë 02.11.2018**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 196, DATË 30.08.2018, “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E BORDIT TË ERE-S, NR. 120, DATË 04.06.2018, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2018 TË SHOQËRISË ALBGAZ SH.A” DHE NR. 121, DATË 04.06.2018, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT 10 VJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHOQËRISË ALBGAZ SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e Gazit Natyror”, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për një ndryshim në Vendimin nr. 196, datë 30.08.2018, “Për një ndryshim në Vendimet e Bordit të ERE-s, nr. 120, datë 04.06.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë Albgaz sh.a” dhe nr. 121, datë 04.06.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë Albgaz sh.a.”

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 196, datë 30.08.2018, miratoi një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE nr. 120, datë 04.06.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë Albgaz sh.a” dhe nr. 121, datë 04.06.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë Albgaz sh.a.”, duke shtyrë afatin e përcaktuar në këto vendime për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Sa më sipër, me shkresën nr. 495/2 Prot., datë 03.09.2018, ERE ka përcjellë pranë “Albgaz” sh.a njoftimin e vendimit nr. 196, datë 30.08.2018, të sipërcituar, duke i bërë me dije edhe detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të munguar brenda datës 20.10.2018.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/4 Prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.01.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 196, datë 30.08.2018, si më poshtë:
  - *Albgaz” sh.a të depozitohet pranë ERE-s jo më vonë se data 20.01.2019: - Miratimet nga Këshilli Mbikqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018 që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43, Prot datë 21.03.2018,”Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.”*
2. Të miratojë ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 196, datë 30.08.2018, si më poshtë:
  - *“Albgaz” sh.a të depozitohet pranë ERE-s jo më vonë se data 20.01.2019: - Miratim nga Këshilli Mbikqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 1018 – 2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43, Prot datë 21.03.2018,”Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.”*
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë Albgaz sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**